



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL II/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 2 (dytë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.02.2024
Ora: 13.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z. Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyqi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj. Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj. Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevshet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Znj.Saranda

Bajraktari

Znj.Mimoza Bajraktari

Znj.Festë Kabashi

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Z.Herolind Limaj

Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;**
- 7. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike në vitin 2023;**
- 8. Shqyrtimi i planifikimit përfundimtar të prokurimit për vitin 2024;**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Jehona Rrafshi - para se të fillojmë me pikën e dytë kam një propozim paraprakisht. Siq jeni në dijen në fshatin Bllacë ka ndodhur një fatkeqësi ku është djegur shtëpia e një pronari i cili është Zenel Lumi. Unë si asamblistë e këtij vendi dhe në koordinim me dy asamblistët tjerë Urim Suka dhe Saranda Bajraktari kemi bërë propozim ose të sqarohemi edhe me zyrtarin ligjor se si është mundësia që ne si Asamble ta ndajmë një fond emergjent për këtë rast.

Kryesuesi - ne jemi te pika e dytë por ti e ngrite një shqetësim që ne kemi dëgju për atë rast dhe na u është dhimbësuar të gjithëve mirëpo kjo është një çështje që duhet të diskutohet me zyrtarin ligjor por edhe me Kryetarin.

Kryetari - është e vërtetë që kemi të tilla raste. Deri para dy viteve kemi pas një fond emergjent i cili ka kalu në Asambleshën komunale të cilin e kemi përdorur për zjarre, për përmbajtje të shtëpive por momentalisht nuk e kemi. Është mirë të caktohet një vlerë por nuk mund ta caktojmë vlerën shumë të madhe. Ne mund

t'ia ndajmë 999€ me komision sepse më shumë nuk kemi të drejtë ligjore. Është mirë të propozohet një shumë, me hy në rend dite dhe është mirë me shku prej mallrave dhe shërbimeve pasi nuk ndërtohet një shtëpi e re por ajo shtëpi ka me u meremetua. Unë ju lus gjithë asamblesë që mos i bartin problemet e asamblesë komunale nëpër familje. Unë ju kërkoj falje sepse nganjëherë nuk po mund të marrë pjesë në Asamble dhe KPF sepse është një agjendë mjaft e madhe e Kryetarit të Komunës dhe kërkoj nga ju bashkëpunim, këshilla për projektet që kemi për Komunën.

Flamur Bytyqi - sa i përket kësaj pike besoj që është një fond emergjent në kuadër të komunës.

Kryetari - ke të drejtë. Ka dy vite që na kanë heq fondin emergjent dhe nuk e kemi më.

Saranda Bajraktari - fillimisht dua një mendim të zyrtarit ligjor se cila mundet me qenë shuma maksimale për me kriju një fond emergjent sepse familja në fjalë ka nevojë emergjente. Jam duke e mbështet mendimin e Jehonës për shkak se nuk është esenca nga është, nuk është esenca e bindjeve politike por esenca është me ndihmu.

Avni Bytyqi - siç e cekim edhe Kryetari, fondin emergjent nuk e ka heqë Kryetari i Komunës sepse nuk ka pas interes sepse pikërisht nga ky fond emergjent iu ka ndihmuar shumë familjeve të cilat kanë pësua nga fatkeqësitë natyrore mirëpo këtë fond e ka heqë ministria. E vetmja mundësi për ti ndihmuar familjes është nga subvencionet por e keqja është se Kuvendi jon nuk ka subvencione përpos Komuna që ka subvencione dhe në bazë të rregullores për ndarjen e subvencioneve Kryetari i Komunës ka të drejtë në vlerë deri 3000€ ti jep ndihma momentale për rastet ekstreme dhe emergjente për personat fizik ndërsa për personat juridik deri në vlerën 5000€.

Kryetari - unë e kam ditë këtë por mos me thënë që Kryetari i Komunës ka nda 3000€ buxhet, unë e kisha dhënë propozimin me shku me 5000, le ta aprovonjë dhe le ta kalon ligjshmërinë e pastaj i ndajmë.

Urim Suka - ne këtu u kordinuam me Jehonën për propozimin në fjalë. Duke dëgju edhe atë që tha Kryetari për mënyrën e financimit, unë nuk mendoj që ne duhet me financua gjithmonë një vlerë për krejt familjen sepse mund ti ndodh naj fatkeqësi naj familje që ka kogja shumë të hyra dhe nuk është e nevojshme ndoshta me pas ai përkrahjen e Kuvendit. Por për rastin që po flasim mendoj që kësaj familje është mirë m'i dal ndihmë ne pak më shumë për shkak edhe të gjendjes ekonomike që e ka. Vlera që ne kishim propozu është afër 10.000€, vendimin Kuvendi me marrë ashtu e pastaj brenda mundësive buxhetore se ku mundeni me i marrë ato sepse ne nuk e dimë. Kërkoj mirëkuptimin e të gjithëve nëse ne mundemi me marrë si vendim dhe kemi bazë ligjore me marrë atë vendim.

Kryesuesi - rendi i ditës zyrtarisht është i mbyllur. Jemi për me ndihmu të gjithë por duhet ti ndjekim procedurat si duhet. Unë jam i pajtimit që ta sjellim seancën tjetër si një vendim të plotfuqishëm.

Jehona Rrafshi - thatë që është mbyll rendi i ditës por ta keni parasysh që jemi në një seancë të njejtë.

Shefket Kolgeci - unë mendoj që nëse kemi të drejtë me e fut te pyetje dhe përgjigje dhe ta diskutojmë.

Jehona Rrafshi - nëse vendoset me diskutu në pikën e fundit të rendit të ditës atëherë po i lë që të gjitha ti diskutojmë atëherë.

Alban Berisha - unë mendoj që mos me na ndodh kjo shpesh edhe me na u kthy vendimi sepse ndoshta e marrim një vendim dhe kthehet. Më mirë është që kryetari me vazhdua me procedura, 3000€ që mundet me i nda pa kalu përmes Asamblesë dhe ju një muaj keni kohë me shqyrtu me Drejtorinë e Financave bashkërisht që cila është mundësia buxhetore që seancën tjetër me ardhë bashkë me konkluzionin përfundimtar se sa mundemi me i ndihmar dhe ta marrim një vendim në Asamble që vërtetë të kryejmë punë për familjen në fjalë.

Kryetari - më vje mirë që shumica janë pro. Unë më as 3000€ s'ka me i nda por vetëm 999€ me komision. Si të doni vendosni por së paku të kaloj në Asamble.

Avni Bytyqi - është rregulla financiare 02/2013 Ministrisë së Financave e cila përcakton qartë procedurat se cilat para publike shpenzohet pa prokurim dhe pa procedurë, një prej kategorive hynë edhe subvencionet. Te kategoria e subvencioneve mundeni me ndërhy te Kryetari i Komunës siç edhe thashë por Kryetari përmendi çështjen se sa ka kompetencë ndërsa te mjetet tjera financiare, pa procedura edhe 20 vendime në Kuvend merrni, nuk e marrin konfirmimin e ligjshmërisë në Ministrinë e Financave për arsye se kërkojnë trajtim të procedurave të prokurimit. Te kategoria mallra dhe shërbime mund të merrni nga secila drejtori dhe të bëni një vlerë 10.000€ por pa procedura të prokurimit nuk zgjidhet kjo çështje, nuk i shkojnë enkas familjes në xhirollogari.

Urim Suka - më së miri është që të hyjë në rend dite dhe ta diskutojmë. Në një anë Kryetari po thotë që është mirë me marrë vendim Asambleja për shkak që mos me marrë përgjegjësinë veq dikush.

Avni Bytyqi - nëse udhëheq procedurat e prokurimit nuk ka kurrëfar përgjegjësie.

Kryetari - për me qenë unë më rehat le të mirret vendimi në Asamblenë komunale. Për 3000€ kemi me pas kërkesa shumë dhe unë ka me ra në lajthitje.

Kryesuesi - në moment kur ne kemi dasht me ndihmu klubin e „Ballkanit“ fillimisht u desht me nxjerr një vendim me nda mjetet e pastaj me sjell vendimin se ku me i orjentu mjetet. Është procedura kështu.

Dardan Berisha - në bazë të informacioneve ajo familje gjendet në kushte të rënda ekonomike por kur jemi te kategoria e subvencioneve, a kemi ndonjë banesë të lirë që t'ja bëjmë një zgjidhje të përkohshme.

Kryetari - përveq këtyre dy lokaleve nuk kemi. Duhet me shpall përmes zyrës së prokurimit material me siguru sepse nuk kemi mundësi me ja lëshuar mjetet kesh në xhirollogari.

Jehona Rrafshi - duke pas parasysh procedurat, unë mendoj që nëse sot nuk caktohet, mos ta lëmë seancën tjetër. Filloni me procedura të prokurimit ju dhe ta mbajmë një seancë të jashtëzakonshme ditët në vijim për shkak se është një rast emergjent dhe nuk mund ti presim procedurat. Kryetari përmendi disa herë që duhet renovimi i asaj shtëpie. Me keqardhje, kjo shtëpi nuk kërkon renovim por duhet të ndërtohet një shtëpi tjetër për shkak që muret janë të plasaritura komplet. Shpresoj që raste te tilla të mos ndodhin.

Visar Kuçi - është fakt që procedurat na marrin kohë dhe unë propozoj një zgjidhje tjetër. Janë 31 asamblesit dhe 10 drejtora. Të ndajmë nga një shumë 100€ secili nga ne dhe vlera mbërrin 4000€ dhe familja mund të filloj me procedurat dhe të filloj me shtëpi deri sa të bëhet zgjidhja nga komuna.

Mevlude Kabashi - edhe unë e pata këtë ide dhe nëse kemi vullnet të mirë unë mendoj që bashkimi bën fuqi. Secili prej nesh mundet me nda një pjesë prej buxhetit familjar dhe m'i ndihmu dikujt.

Alban Berisha - Visar, nuk kisha pas dëshirë kurrë për këso raste pavarësisht zemrës tuaj humane dhe e respektoj këtë por në mënyrë publike nuk kisha pas dëshirë me bë këtë sepse këto zakonisht bëhen privatisht, mblidhet një indikacion dhe ndoshta dikush jep më shumë se 100 e dikush 1000 por dikush 20.

Është e ndieshme çka po them por për mua në një seancë publike me u propozu një iniciativë e tillë mua nuk më pëlqen. Një iniciativë e tillë nisat privat, me biseda private e pastaj mund të bëhet publike sepse mund të bashkangjiten edhe njerëz tjerë. E kërkoj mirëkuptimin tuaj dhe ju respektoj.

Visar Kuçi - unë po e ndiej veten ma keq që po e debatojmë këtu për me dhënë një shumë që ndoshta edhe s'na lejohet. Unë po e propozoj dhe nuk kemi me votu.

Labinot Halitjaha - te pjesa e subvencioneve Kryetari dhe zyrtari ligjor e sqaruan ndërsa 10.000€ që e diskutoi Urimi, në prokurim nuk kemi mundësi me vazhdu sepse duhet vetëm me dokumenta duhet dikush me konkuru. Forma e vetme mbetet me subvencionu. Drejtori tutje jep sqarime.

Kryesuesi - te pyetje dhe përgjigje do ta diskutojmë edhe një herë këtë temë. Hap debatin për pikën 2.

Kryesuesi - pasi nuk ka debat, sa jeni të pajtimit me dhënë në shfrytëzim? Të gjithë pajtohen që të jepet për 15 vite në shfrytëzim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2 që të jepet 15 vite në shfrytëzim.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;

Kryesuesi - e elaboron pikën 3 dhe hap debatin.

Shefket Kolgeci - kërkoj sqarime nga drejtori. Sa po merret, sa po jepet dhe çfarë interesi është dhe nëse është interes i përgjithshëm normal që jemi për.

Kryetari - ne nuk vendosim sa metra japim dhe sa metra marrim. Ne e qesim në Asamble, shkon te Ministria e Pushtetit lokal, aprovohet pastaj shkon në Ministri të Financave dhe është një komision i veçantë që merret me këmbimin e pronave. Rast konkret kemi pas te stacioni i policisë. Kryetari tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - në bazë të ligjit për këmbimin e pronës komunale vendos Asambleja komunale ndërsa pjesa tjetër për vlerësim shkon në ministri por për me vendos për pronë komunale ne marrim vendim.

Nëse është interes publik dhe i kemi ndjek të gjitha procedurat dhe vërtet është interes publik atëherë ne e vendosim por nuk vendos ministria.

Avni Bytyqi - ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme si dhe rregullorja e cila i përcakton procedurat për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, e kërkon paraprakisht që kur do të fillojë një procedurë për këmbimin e pronës publike me pronë private, paraprakisht prona private shpallet pronë me interes të përgjithshëm dhe tek kur atëherë shpallet pronë me interes të përgjithshëm shkon për konfirmim të ligjshmërisë në MAPL kthehet dhe një varg dokumentesh tjera ka me i plotës ekzekutivi para se me ardhë çështja në Kuvend. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - neni 25 pika 5 e thotë që komuna duhet ta vlerësoj pronën paraprakisht. Ne duhet ta dimë cili është interesi publik që ne duhet me këmbi pronën publike me atë private.

Avni Bytyqi - te neni 1 shkruan: qëllimi i fillimit të procedurës është rregullimi i infrastrukturës rrugore, infrastrukturës për interes të përgjithshëm dhe ky është qëllimi dhe arsyeja.

Liridon Fandaj - ne mund të themi veq shpall interes publik por nuk ke një vlerësim të saktë të asaj prone.

Avni Bytyqi - ekzekutivi nuk mund të bëj vlerësim por vlerësimin e bën Ministria e Financave.

Liridon Fandaj - nuk po them vlerësim financiar por vlerësim për interes publik.

Alban Berisha - në takimin që kemi pas ne si grup parlamentar i kemi shqyrtu këto pika dhe na ka pëlqy ky vendim për shpallje të interesit të përgjithshëm dhe kemi vendos me votu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

27 për, 3 abstenime, Miratohet pika 3.

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;

Kryesuesi - elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - në parim secila lëndë që ka për qëllim rregullimin e statutit të pronës në atë mënyrë që qoftë rruga, qoftë prona sikurse ajo publike dhe ajo private, të merr status përfundimtar ku as prona private mos të jetë pengesë për rrugën e as rruga pengesë për pronën private, jemi pro. Problemi qëndron që ky pushtet as idenë nuk e ka që para fillimit të investimit në rrugë duhet elaborat shpronësimi, duhet vlerësim për pjesën që i merr pronarëve privat, po ashtu miratim nga pronarët për një gjë të tillë e mandej të filloj implemtimin e këmbimit të rrugës pasi që të ketë përfunduar hartimi i projektit. Pra, ju po i shtroni rrugët e pastaj po ju kujtohet që rrugët i keni shtrur në prona private. Problemi tjetër qëndron në faktin se kjo parcellë për të cilën jeni thirr se është interes publik, ju po trajtoni vetëm parcellën si interes publik dhe nuk po trajtoni rrugën si interes publik sepse po të trajtonit rrugën si interes publik do të trajtonit edhe parcellat 1256/1, 1256/4, 01062/4, 01062/5, 00819/3 etj. Në atë mënyrë që vërtetë rruga „Luigj Nikolla“ të trajtohet një herë e mirë e të zgjidhet përfundimisht satusi i asaj rrugë. Ju këtë rrugë po e trajtoni pjesërisht, po bëni ndërrim vetëm me një pronar dhe po e zgjidhni çështjen e kësaj rruge vetëm në një segment për të cilin brenda këtij segmenti që po trajtohet nuk keni mundësi me lëshu leje ndërtimore.

Urim Suka - pak a shumë e dimë që problematika të tilla ku ndërtohen rrugë dhe merret edhe prona private ndodhin shumë dhe ndoshta ka raste kur Komuna nuk mundet edhe m'i evitu. Brenda mundësive që ju keni si ekzekutiv, është me tepër rëndësi që para investimit të ndonjë rruge të nisen procedurat e shpronësimit paraprakisht për faktin që dëmi që po i bëhet buxhetit të Komunës është i madh. Sepse nëse e bën procedurën e shpronësimit para se të bëhet infrastruktura në atë zonë, shpronësimi i asaj prone ka me qenë me kosto shumë më të vogël dhe nëse ndodh e kundërta që shpronësimi bëhet pasi të bëhet infrastruktura, kostoja ka me qenë shumë e madhe.

Kryetari - këtë që po e thoni ju, keni të drejtë. Nëse fillojmë me punu me ligjin që është në fuqi, asnjë mjet brenda viti nuk kryhet për arsye se ne me ligjin që është në fuqi duhet që atë rrugë që e shpallim n'tender duhet edhe me shpronësu. Te rruga „Luigj Nikolla“, merrne buxhetin 2016-20217 çdo vit është bart kjo rrugë për arsye se ka aps probleme pronësore. X personit ju ka shpronësu vetëm 10 ari por vlerësimin nuk e kemi bë ne, vlerësimin e ka bë komisioni që ia ka caktu çmimin 5000€. Paret i kemi lëshu por lëndën e kemi n'gjykatë për arsye se ai po kërkon më shumë. E cekim Selmani dhe ke plotësisht të drejtë Selmani por

në qoftëse ia ke marrë dikujt pronën dhe e ke shfrytëzuar një kohë të gjatë dhe po kërkon me këmbë e nuk po kërkon para, nëse në aspektin profesional i bie mirë Komunës është në rregull. Kryetari tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - rruga „Luigj Nikolla“ tri herë ka dal në tender dhe është shtrur kjo rrugë. Si ka mundësi me shkel ligjin e me shtrur rrugën „Luigj Nikolla“ e sot me ardhë për këmbim kjo si interes publik?

Kryetari - rruga „Luigj Nikolla“ është shtrur tri herë me fazë-fazë dhe nuk është shtruar përnjëherë. Ne kur e kemi marrë vendimin prej komisionit qeveritar e kemi shtrur atë rrugë por kemi vazhdu edhe dy faza.

Liridon Fandaj - nëse investimi publik bëhet me një pronë private pa shpronësim, është një lloj përgjegjësie.

Kryetari - aty janë 20 shtëpi dhe Komuna është e interesuar me bo zgjidhje për ato familje.

Liridon Fandaj - unë të pyeta se pse e ke shtrur e nuk e ke shpronësuar?

Kryetari - unë e kam shpronësuar dhe e kam shtrur por janë disa pjesë të vogla që kanë mbetur.

Liridon Fandaj - është përgjegjësi e jotja nëse thua ashtu. Shkojmë në vend të ngjarjes dhe e shohim a e ke shpronësuar atë.

Visar Kuçi - rruga „Luigj Nikolla“ kur është investuar, ka filluar shpronësimin në asamblenë e kaluar me njërin prej pronarëve. Procedura nuk ka përfunduar për shkak se pronari nuk është pajtuar me shumën që është dhënë sepse vlerësimi është bërë me mjete financiare kurse këtu në këtë rast unë pajtohem me Selmanin dhe me të gjithë këtu që janë edhe me të gjithë komunat sepse ka probleme dhe këto probleme të gjitha komunat janë tu i përcjell. Drejtori tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - qëllimi im është që ju po i bëni investimet pa shpronësim. A është bërë investimi publik në pjesën ku do me këmbë komuna sot?

Visar Kuçi - ka investim publik.

Shefket Kolgeci - a është e vetmja pengesë kjo për atë rrugë. Ne jemi për me zgjidh këtë problem por a e keni shikuar rrugën Luigj Nikolla që ka probleme? Le të shpallet interesi i përgjithshëm për krejt dhe le të rregullohet një herë e përgjithmonë ajo rrugë. Unë mendoj që ju si drejtori e urbanizimit me bërë një inqizim të asaj rruge dhe ku ka nevojë me zgjeru dhe me zgjidh atë problem.

Visar Kuçi - arsyeja se ka ardhë kjo pronë për këmbim është se pronari ka bërë disa herë kërkesë të ne për me këmbë pronën. Fatmirësisht brenda parcellës së pronarit, me atë parcellë komuna ka pronë dhe atij iu ka marrë prona dhe në mungesë të mjeteve ne nuk mund të vazhdojmë.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 4.

26 për, 3 kundër, Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ne si LDK në parim sa herë na vin këto dokumentet që e ndihmojnë Komunën në plane të veprimit e sidomos edhe për eficiencë, jemi që ti mbështesim sepse e dimë që është interes i komunës m'i pas këto plane si dokumente përmes të cilave pastaj mund të fitoj donacione të ndryshme që kanë të bëjnë me fushën për eficiencë apo edhe ta ketë komuna një pasqyrë me anë të të cilave do ti parashih investimet e veta me qëllim të rritjes së eficiencës së energjisë. Ajo që neve na shqetëson është fakti që në shumicën e rasteve kur ne i miratojmë këto plane dhe dokumente, në shumicën e rasteve këto miratohen, shkojnë dikun dhe më nuk shikohen fare dhe fillohet me punu pa u konsultu më me këto dokumente. Urojmë që ky dokument kur të miratohet, i cili do ta ketë edhe mbështetje tonë, ky dokument ta ketë edhe fokusin tuaj si qeveri, të ketë mbështetje financiare në projekte të caktuara që rrisin eficiencën e energjisë edhe në Komunën tonë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - Sot kur falsim për projekt-vendimin për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2027, më lejoni të theksoj që transparencë nuk është thjesht dokument që i ka munguar komunës tonë por është më shumë se kaq, është vullnet që ky pushtet nuk e ka për të zbardhur çdo dyshim të ngritur nga ne apo edhe qytetarët përmes kërkesave e ankesave që parashtrorjnë në baza ditore. Për të qenë më konkret, më lejoni të theksoj disa fakte që dëshmojnë për mosgadishmërinë tuaj për të qenë transparent në shumë kërkesa e çështje që janë ngritur nga ne apo qytetarët. Para dy dite unë kam pranuar një shqetësim nga disa biznese që operojnë në qendrën zejtare 2, të cilët kishin parashtruar një ankesë në Drejtorinë e Urbanizmit lidhur me planifikimin që kjo drejtori ka bërë me rastin e krijimit të hapsirave për parking në rrugën „Hasan Prishtina“ në Suharekë.

Por paramendoni, ju as nuk i keni kthyer përgjigje ankesës së tyre, qoftë edhe refuzim të saj e leje më ti bëni zgjidhje problemit që ata kanë ngritur zyrtarisht tek ju. Në shumë shkresa e kërkesa këtu në kuvend që ne si përfaqësues të qytetarëve adresojmë ka plot raste kur ne nuk marrim përgjigje fare ndërsa në rastet kur marrim përgjigje ato në shumicën e rasteve nuk janë të plota. Gjatë kësaj kohe unë kam pranuar disa informata nga qytetarët për disa kërkesa që ata kanë adresuar tek ju dhe nuk kanë marrë as përgjigje fare për to. Në fund dhe ajo që është kryesorja është fakti që ju keni përdorur numrat këtu në asamble për të penguar formimin e komisionit për mbikqyrjen e implementimit të projekteve të listës së investimeve kapitale siq është miratuar nga ju në asamble, përmes kësaj ju nuk keni leju që të bëhet transparent secili shpenzim i parasë publike edhe përkundër që ne ka dy vite që e kërkojmë formimin e këtij komisioni.

Prandaj mund të konstatojmë që ju nuk keni vullnet për të rritur transparencën komunale por ju keni gadishmëri vetëm sipërfaqësisht të adresohet kjo çështje, thjesht sa për të mashtruar opinionin me fakte që nuk qëndrojnë. Pra kuptojeni, nuk është transparencë vetëm publikimi i kontratës në platformën e komunës e në anën tjetër rrugët të cilat janë në kontratën e publikuar nuk janë fare të shtruar ndërsa ne kur kërkojmë që kjo çështje të zbardhet përmes një komisioni të përbashkët, ju nuk e lejoni themelimin e tij.

Kjo nuk është transparencë dhe nuk jeni në gadishmëri për transparencë sepse nuk ka si të jeni transparentë karshi gjithë këtij keqplanifikimi e keqmenaxhimi të buxhetit. Ne si LDK jemi që ky dokument të miratohet e të zbatohet gjithnjë në funksion të rritjes së transparencës komunale. Tani me qëllim që ky dokument të jetë në funksion të rritjes së transparencës dhe informimit të drejt të qytetarëve, ne si LDK mendojmë që ky dokument përveç çështjeve që trajton, ti shtohen edhe këto propozime: 1. Të lejohet nga pushteti që të formohen komisionet mbykqyrëse për punën e ekzekutivit me theks të veçantë të formohet komisioni për mbikqyrjen e implementimit të listës së investimeve kapitale për vitin 2023. 2. Transmetimet e seancave të Kuvendit të komunës të jenë sa më profesionale. (përkatësisht ku në disa raste Radio Vala ka qenë e angazhuar, kualiteti ka qenë shumë më i lartë se tani). Pra të paktën të kemi transmetimin e seancave sipas formatit që ka bërë Radio Vala. 3. Qëndrimet e opozitës për temat që trajtohen në asamble dhe jo vetëm, të pasqyrohen në llogarinë e komunës në fcb apo edhe platformën e komunës për informim të aktiviteteve. 4. Të krijohet hapsira brenda institucionit të komunës që grupet parlamentare të kenë zyrë për punë dhe infrastrukturë përcjellëse që mundësojnë vizitat në teren për projektet që implementohen. Pres që propozimet tona të miratohen dhe ti shtohen këtij dokumenti që pastaj të miratohet në tërësi ky projekt-vendim.

Visar Kuçi - Urim përmende rastin e parkingjeve të shtëpia e shëndetit. Asambleistaja Zyrapi ma ka bërë pyetjen në një seancë dhe ma ka treguar edhe videon. Ka qenë shumë shqetësuese për ne dhe për shumë qytetar kur vetura e ambulancës nuk ka pas mundësi me kalu në atë pjesë të rrugës në mënyrën si kanë qenë parkingjet. Ne e kemi bërë më të mirën dhe prej asaj dite nuk ka pas probleme për veturat e ambulancës. Që t'kanë thënë ty, më kanë thirrur edhe mua. Janë shqetësues por janë shqetësues për interes personal të vetin për shkak se kur po i vje kamioni atij, spo mund të parkohet për ti zbrazë mallrat. Ne e kemi aprovuar një rregullore për parkingje dhe ai mundet me ardhë me marrë një pëlqim për parkingun.

Urim Suka - unë nuk ngrita shqetësim për mënyrën qysh po funksionon tash e qysh ka funksionu më herët. Shqetësimi im është që pse nuk ju ke kthyer përgjigje kur ata tu kanë drejtu zyrtarisht, qoftë

refuzim,çoftë me ja bë një zgjidhje,çoftë me shkrim,çoftë me i ftu?Pra ajo që them është pse nuk i ke kthy përgjigje?

Visar Kuçi - unë çdo ditë e frekuentoj atë lagje.Ia kam sqaru atij zotëriut edhe në vend të ngjarjes dhe as një ditë rruga nuk është blloku por jo për interes personal me bë aq të madhe.Të gjithë qytetarët aty janë të kënaqur sepse nga 15 parkingje sot janë 39 parkingje.

Urim Suka - mirë por atij duhet me ia kthy përgjigjen me shkrim.

Visar Kuçi - përgjigje më të mirë se me dal vet n'teren ku po don.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Urim Suka - Patëm disa propozime dhe është mirë të votohen propozimet për procedurë para se të hedhet në votim pika.

Kryesuesi - unë e hodha në votim dhe nëse kalon,kalon.Nëse nuk kalon i hedh në votim propozimet.

Urim Suka - edhe praktikën që e kemi pas më herër së pari votohen propozimet,pastaj komplet.

18 për, 8 kundër, 1 abstenim

Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike në vitin 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - është hera e tretë që menaxheri i zyrës së prokurimit nuk vje këtu me raportu as për kontratat e nënshkruara dhe as për planin e prokurimit.

Kryesuesi - unë i kam thënë që duhet me qenë prezent.

Selman Kolgeci - lidhur me këtë raport që e keni sjell sot shqetësohem për mënyrën se si zyra e prokurimit vendos që ti shpall e ti udhëheq procedurat e prokurimit, respektivisht më shqetëson fakti se si po shpenzohet buxheti që e ka miratuar ky kuvend.Është e vërtetë që kemi pas kritika për buxhetin dhe prapa atyre kritikave qëndrojmë prap sepse e kemi ditur dhe vazhdojmë ta dimë që buxheti për vitin 2023,si ai për vitin 2024 nuk ka qenë në ndarje të drejta e nuk kanë qenë të adresuara si duhet,shtoj kësaj faktin që komuna jonë pjesën më të madhe të investimeve e realizon me paramasa shabllon. Sa përqind është realizuar plani i prokurimit për vitin 2023 që vet zyra e prokurimit ia ka sjell këtij kuvendi ?Sa është numri i projekteve për të cilat kjo zyre ka zhvilluar procedura të prokurimit dhe që ka lidhur kontratë e që ato investime nuk gjenden në buxhetin e viti 2023 e as në planin e prokurimit të vitit 2023?A ka vendime prej autoritetit që do të duhej të merrte vendim për ndonjë ndryshim eventual të listës së investimeve? Ajo çfarë ka vepruar ky pushtet me këto kontrata është tjetërsim i vullnetit të asambleistave,është anashkalim i vendimit të kuvendit.Nga buxheti që kuvendarët e kualicionit qeverisës e kanë miratu për vitin 2023,35 projekte nuk i ka realizuar fare që vlera totale e parashikuar për ato procedura është mbi 750.000€.Gjithëashtu 27 procedura janë fillu dhe është nënshkru kontratë për to jasht planit të prokurimit e jasht buxhetit të viti 2023 që në vlerë monetare kapin vlerën 2.380.000€.Zoti Halitjaha dhe zyrtari ligjor nëse mund të na tregojnë sa është limiti që kanë të drejtë me deviju buxhetin dhe sa përqind guxojnë me lëviz buxhetin.Nëse është marrë vendim për këto projekte,kush është ai që e ka dhënë vendimin tjetër për m'i ndryshu këto projekte.

Labint Halitjaha - pjesën më të madhe të vitit 2023 buxheti është shpenzu në bazë të planifikimit por gjithmonë gjatë rrugës në punime dhe në faza të ndryshme të punës ka edhe pengesa,andaj në kohën kur ka pas pengesa kemi bë edhe ndryshime të planifikimit të buxhetit me vendime të ndryshme të atij që do t'vednos për ndryshimin e buxhetit.Punën e ligjit besoj që e din zyrtari ligjor se sa është pjesë e asaj që duhet të ndryshohet pjesa e buxhetit te investimet kapitale,është 5 % e buxhetit që ka të drejtë Kryetari me bë ndryshime prej një pjese në pjesën tjetër në të njejtën kategori.

Avni Bytyqi - drejtori e përmendi që 5% i lejohet Kryetarit të komunës me e lëviz buxhetin duke prejashu kategorinë e pagave dhe unë s'kam ç'të shtoj më.

Selman Kolgeci - unë nuk po dyshoj në atë që e tha drejtori dhe z.Bytyqi.Nëse është 5%,a mundemi m'i pa ato vendime se kush ka marrë vendim mos m'i bë 35 projekte prej buxhetit të 2023-tës dhe kush ka marrë vendim m'i bë 27 projekte të reja me vlerë 2.380.000?

Visar Kuçi - nuk ka mundësi,nuk është kështu.

Selman Kolgeci - unë e ftoj Visarin dhe ia jap dokumentacionin që e kam edhe unë edhe ti dhe të nënvizune.

Visar Kuçi - nuk është e vërtetë sepse planifikim e prokurimit e bën secili drejtor.Nuk varet prej buxhetit dhe ti ma voton buxhetin mua dhe projektet çka i kam dhe unë e bëj planifikimin dhe varet a i qes dy projekte apo një projekt

Selman Kolgeci - ja ku i ke projektet që nuk i ke realizu hiq.A ke bo procedura a s'ke bo,në raportin e kontratave për vitin 2023 nuk ekzistojnë.

Selman Kolgeci dhe Visar Kuçi tutje vazhdojnë dhe replikojnë njëri tjetrin.

Shefket Kolgeci - vitin e kaluar e kam bë një kërkesë për rrugën „Dy Rrahët „ në fshatin Vraniq ku kemi propozu që me dal një ekspert sepse duhet të vendoset një mur mbrojtës aty.A keni bë në atë drejtim diçka dhe a keni mendjen me bë diçka në atë drejtim?Është shumë e nevojshme të rregullohet ajo rrugë.

Agim Bylykbashi - nëse nuk ka qenë në buxhet s'ka pas si me u shtru.Sa i përket mureve mbrojtëse duhet ta kemi parasysh që ne nuk ka mundësim me ndërto mure mbrojtëse sepse në paramasë ai muri mbrojtës mund ti merr dy-tri rrugë që është problem.Unë do të marrë informata.

Shefket Kolgeci - është shumë e thjeshtë.Zyra e urbanizmit me katastrofë shkon i bën matjet pastaj është kryesia e fshatit,e bëjnë projektin dhe e caktojnë koston.Nuk është rrugë e gjatë.

Liridon Fandaj - kam një vërejtje.Në KPF ka qenë menaxheri dhe ne i kemi dhënë disa vërejtje në raport të tij dhe i njeiti dokument na është përcjell prap.Nëse vje një pikë në KPF dhe është gabim dhe ne kërkojmë me korigju,mos t'na përcjelllet prap e njeita ose të paktën të vje fizikisht dhe t'na jep ato sqarime që ne i kemi ngrit në KPF.

Kryesuesi - pajtohem me ty sepse e ke dhënë si vërejtje.

Urim Suka - ne si opozitë gjatë viti 2023 kemi folur shumë për problemet me kontrata e për mënyrën e menaxhimit të shpenzimit të parasë publike.Ndërkohë sot kur po e shqyrtojmë raportin e kontratave shpresoj që jeni duke e pa edhe ju numrin e madh të problemeve që vërehen e dhe në këtë raport që ky pushtet vet e ka sjell. Paramendoni për ndërtimin e kolektorit në rrugën „Skënderbeu“ ky pushtet ka hartuar një kontratë në vlerë prej 929.426 €,ndërkohë që nga kjo kontratë janë shpenzuar 22.100€.Por çudia më e madhe është në faktin që për këtë projekt,në bazë të përgjigjes që kemi marrë nga drejtori në seancën e kaluar,edhe mjetet e planifikuara për ndërtimin e rrugëve lokale segment i rrugës Skënderbeu,Aleksandër Moisiu seg. dhe Bajram Curri seg. në Suharekë janë marrë dhe janë shpenzuar për projektin e kolektorit në rrugën „Skënderbeu“. Kjo jo vetëm që është keqplanifikim e keqmenaxhim por kjo është tepër e pakuptueshme dhe pres të na sqaroni në detaje se pse ka ndodh një gjë e tillë.

Pse nuk është lidhur kontrata për rrugët në Suharekë me që ju vet i keni planifikuar rreth 30.000€ për ndërtimin e tyre? Pse nuk janë shtru këto rrugë? Pse një pjesë e këtyre mjeteve janë pagu për kolektorin e rrugës „Skënderbeu“ kur ju keni pas mjete në këtë projekt dhe ju kanë mbetur pa shpenzuar? Gjithëashtu në këtë raport figuron që për ndërtimin dhe sanimin e kanalizimeve në komunë keni lidh një kontratë në vlerë 209.454 € ndërsa po në këtë raport figuron që nga kjo kontratë janë shpenzu vetëm 16.279 €.Gjithëashtu ju keni lidh edhe një kontratë tjetër për ndërtimin dhe sanimin e kanalizimeve në komunë dhe fshatrat përkatës në vlerë prej 223.550€ mirëpo shpenzimi në këtë kontratë është deklaruar në këtë raport vetëm 44.645 €. Tani të dashur kuvendar e qytetar paramendoni ky pushtet në dy kontrata të lidhura gjatë vitit 2023 e të deklaruar në këtë raport në vlerë rreth 433.000€,i ka shpenzu vetëm 60.000€, gjithnjë sipas të dhënave të deklaruar në këtë raport. Nëse kjo është kështu siç figuron në këtë raport, atëherë le të qohet dikush dhe të tregoj se ku kanë mbetur këto para.Ndërsa ajo që i bën edhe më të çuditshëm këto të dhëna është fakti që në raportin e shpenzimit të buxhetit që kemi shqyrtuar muajin e kaluar ju për projektet e kanalizimit keni raportuar që i keni shpenzuar rreth 300.000€.Tani a mund të tragoni se për rprojektet e kanalizimit a janë shpenzu rreth 300.000€ siç keni deklaruar një muaj më parë apo 60.000€ si siç po deklaroni në këtë raport sot.Mospërputhje të tilla ka edhe në shumë projekte tjera për të cilat nuk po flas sot.Të nderuar qytetarë sjellja e këtij pushteti me menaxhimin e parasë publike

është shumë më keq nga kjo që po dëgjoni nga unë sepse unë e kam të pamundur të mbuloj gjithë këto shkelje që ky pushtet i bën. Ndërsa me qëllim të zbardhjes të secilit pretendim ne kemi kërkuar që të formohet një komision i përbashkët nga të gjitha partitë por siç e dini kjo kërkesë e jona është refuzu disa herë nga ky pushtet sepse këta e dinë që gjendja është edhe më keq se që e paraqesim ne prandaj edhe e pengojnë formimin e komisionit. Për ta përmbyll fjalën time, të dashur kolegë e kuvendar, ky raport që edhe ju e keni para vetes dhe kjo mënyrë e shpenzimit të parasë publike nga ky pushtet është alarm që ne sa më parë të marrim masa përgjegjësitë si kuvend dhe ta pengojmë këtë logjikë të mbrapsht qeverisëse.

Përndryshe ne nuk po përmbushim betimin që kemi bërë që në ditën e parë të këtij mandati dhe nuk po mbrojmë interesat e përgjithshme qytetare por në një formë apo tjetër i nënshtrohemi interesave të ngushta të një rrethi të ngushtë të oborrit qeveritar dhe po dëmtojmë interesin qytetar.

Agim Bylykbashi - me që e përmendi Urimi një arsye që e kam dhënë në asamblenë e kaluar dhe në shkresën që ia kam dërgu zyrës së LDK-së për një kërkesë që kanë bërë, është përvjedh një gabim që unë realisht kërkoj falje sepse mjetet e ndara nga projekti i rrugës „Skënderbeu“ nuk kanë shku në kolektor por është pagu kontrata 2 vjeqare në shumë prej 95.622€ e vitit 2022-2023 dhe dy vlerat tjera prej 9.100 dhe 5.277 janë në rregull.

Urim Suka - nëse nuk gaboj në përgjigjen që na keni kthyer dikun 95.000€ i keni deklaruar që kanë shku te kolektori, a është kështu?

Agim Bylykbashi - jo.

Urim Suka - atëherë e ke dhënë informatën gabim. A mund të na tregosh që këto 300.000€ pse nuk janë shtrur në rrugët në Suharekë ku po flasim? Pse nuk është bërë kontratë? Pse nuk janë shtrur ato rrugë të cilat i keni planifikuar dhe ku kanë shku? Ne e dimë mirë që e drejta e Kryetarit për me devijuar një investim prej një projekti në projektin tjetër është deri në 5 % të buxhetit por ajo bëhet me një arsyetim të bazuar dhe nuk mund ta devijosh vetëm se po don. Ato që përmendi Selmani janë të vërteta dhe nëse doni me zbardh, hajde e formojmë komisionin dhe e shohim cila është e vërteta e atij devijimi dhe atyre që i ngritëm.

Agim Bylykbashi - unë mund ta jap sqarimin vetëm për kërkesën që e ke bërë dhe të ktheva përgjegje. Për të tjerat duhet me marrë informata dhe me të dhënë sqarime.

Pika 8. Shqyrtimi i planifikimit përfundimtar të prokurimit për vitin 2024;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - kam pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike pasi që në kornizën buxhetore shohim që disa prej rrugëve janë të emërtuara ndryshe dhe të votuara ndryshe ndërsa në planifikim të prokurimit janë me emra të ndryshëm. Cila është arsyeja? Rruga e Peqanit „Lulëkuqja“ nuk është në kornizën buxhetore dhe e kemi hequr edhe atëherë se ajo ka dalë dy herë në tender por nuk është e përfundime. Tash e shoh që në planin e prokurimit është Lulëkuqja dhe në kornizën buxhetore është rruga te shkolla dhe rruga „Amerika“.

Agim Bylykbashi - nuk e di saktë si është e shkruar por çdo projekt që hyn në sistemin PIP, ne nuk guxojmë me ndryshu atë emërtim.

Liridon Fandaj - mund ta shikosh edhe vet si është mirartu. Unë kam pas shqetësim dhe për atë thash që është e pakuptimtë dhe jo transparente që ai me ardhë dhe me na i dhënë ato sqarime që ne i kemi kërkuar në KPF.

Agim Bylykbashi - kjo nuk është çështje e imja, Drejtoria e Financave merret me këtë punë. Buxheti kur të votohet në shtator është buxheti përfundimtar për vitin e ardhshëm dhe ZKF dhe DEFB e dorëzojnë buxhetin në ministri dhe secili projekt kapital regjistrohet në sistemin PIP dhe zyrtarja është përgjegjëse.

Liridon Fandaj - unë edhe atë ditë e kam sqaruar dhe ai atë ditë e ka pranuar ashtu si po them unë. Vetëm nëse në kuvend miratohet diçka e në zyre ndërrohet. Është e pakuptimtë kjo.

Urim Suka - gjatë shqyrtimit të planit të prokurimit unë kam hasur në disa probleme të cilat po e përcjellin këtë pushtet në vazhdimsi dhe e cila tashmë është bërë formulë qeverisëse e këtij pushteti. Në këtë planifikim në fshatin Duhël figuron që do të hidhen në tenderim rrugët: Vëllezërit Qatani-segment dhe rruga Hivzi Sylejmani. Mirëpo në planifikimin e buxhetit që ju vet e keni planifikuar në seancën e jashtëzakonshme të 2 tetorit për fshatin Duhël ju keni miratuar ndërtimin e rrugëve: Vëllezërit Qatani-

segment dhe rrugën Tajar Hatipi. Tani siç besoj po e kuptoni nga miratimi i buxhetit në tetor deri te ky plani i prokurimit kemi një ndryshim të rrugëve që do të ndërtohen në fshatin Duhël. Cila rrugë do të shtrohet në fshatin Duhël, rruga Tajar Hatipi e cila është miratu në seancën e jashtëzakonshme të 2 tetorit kur është mirartu buxheti apo rruga Hivzi Sylejmani siq e keni paraparë në planin e prokurimit? Pse ka ndodh ky ndryshim dhe kush e ka bërë një gjë të tillë? A është shkelje ligjore një ndryshim i tillë për faktin që kuvendi është autoriteti i vetëm që bën miratimin e buxhetit ndërsa ekzekutivi vetëm duhet ta implementoj sipas miratimit nga kuvendi? Gjithëashtu një problem të njejtë e kemi edhe në fshatin Peqan. Në këtë fshat me rastin e miratimit të buxhetit janë planifikuar rrugët: Mursel Fandaj, Amerika dhe rruga te shkolla. Ndërsa tani me planifikim përfundimtar të prokurimit figurojnë rrugët: Lulëkuqja dhe Amerika. Kush e bëri këtë ndryshim? Me çfarë baze është bërë ky ndryshim? Çka do të ndodh me rrugën te shkolla meqë qenka hek në këtë plan? Probleme të tilla ka edhe në vendbanimet tjera dhe kjo vërtetë është e pakuptueshme për mua. Fakti që dikush nga ekzekutivi i ndryshon siç vet dëshiron miratimin e buxhetit që ne si kuvendar e bëjmë, për mua është ndërhyrje direkte në punën tonë dhe shkelje e çuditshme që ky ekzekutiv bën në vazhdimësi. Një ndërhyrje të tillë e kemi pas edhe në mos përfshirjen e e propozimeve të kuvendarëve për rrugët specifike që ata propozuan në seancën e jashtëzakonshme të 2 tetorit me rastin e miratimit të buxhetit. Këto propozime të tyre u votuan veq e veq dhe pastaj në tërësi mirëpo kjo rezultoj vetëm një mashtim për të marrë votën e tyre sepse ato propozime nuk u futën fare në buxhet. Kjo qasje është skandaloze dhe për këtë duhet dikush të jap llogari. Këtë qasje duhet ta ndalim ne si kuvend ndryshe roli jonë në këtë institucion nuk ka fare kuptim. Prandaj ju ftoj të gjithëve ta ngrisin zërin bashkarisht me qëllim të pengimit dhe parandalimit të kësaj logjike të mbrapsht qeverisëse e cila po degradon nga viti në vit. Kërkoj sqarime rreth: Planifikimit - Furnizim me Komposter 20.000€ (Për çka është fjala); Furnizim me impute bujqësore 80.000€; Furnizim me paisje të ndryshme për praktikë profesionale për nxënësit e shkollave të mesme 60.000€.

Agim Bylykbashi - nëse është bërë ndonjë gabim, nuk e di por nuk ka shancë asnjë projekt kapital mu inicu në qoftëse nuk është në PIPA me emërtime të njejtja. Sa i përket projektit me kompostera, kemi një projekt me Xhajnën dhe ne si drejtori e shërbimeve publike kemi mendu me bo një projekt të tillë që në disa fshatra ose në qytet me shpërnda disa kompostera.

Ardian Kotorri - te plani i prokurimit që e kam dërgu unë është Furnizim me mekanizëm bujqësor por zyrtarja që bën rregullimin te PIPA ka mundësi që e ka gjet një term tjetër por realisht është furnizim me mekanizëm bujqësor. Drejtori tutje jep sqarime.

Agim Bylykbashi - me sa e di është një projekt që e kemi me USAID me kontratën sociale.

Urim Suka - te 20.000€ e përmende Xhajnën dhe këto 20.000€ keni mi dhënë ju si komunë. A ka me dhënë edhe Xhajnë?

Agim Bylykbashi - ne kemi bërë plan në bazë të programeve që kemi me Xhajnën për ambientin.

Urim Suka - sa i përket komposterave, me i dhënë 20.000€ për këtë fenomen, ndoshta për ambientalista është ide e mirë por me i hargju 20.000€! këto zakonisht në fund po dështojnë si projekte dhe më duket pak shpenzim i madh.

Pika 9. Pyetje dhe përgjigje;

Shefket Kolgeci - pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike. Ne në fshat ende nuk e kemi përmbyll procesin e kanalizimit por një pjesë që e kemi kry në fillim të 2023-tës mbi 70 % nuk funksionon. Andaj unë kërkoj nga drejtorja juaj në bashkëpunim edhe me Kryetarin me formu një komision ekspertësh në nivel t'komunës dhe në bashkëpunim me kryesinë e fshatit ku edhe unë jam anëtar i kryesisë së fshatit me caktu një termin dhe me shku me vlerësu. Unë mendoj që mund të rregullohet, mirëpo edhe një pjesë e fshatit është ende pa kanalizim që ne i themi mbi shkollë.

Agim Bylykbashi - ne e kemi projektin e kanalizimit. Unë shqetësimin tuaj do ta përcjell te menaxheri i kontratës. Për kanalizimin e vjetër që është prish pak e kemi problem, nuk e di a ka garancion kompania që e ka pas më herët.

Alban Berisha - Shumë po ndihem i injorum prej vetvetës së pari dhe ndoshta edhe prej kolegëve sepse nuk është serioze kjo. Kryesues duhet me ndrru diçka ose me bo një startegji, çdo 1 orë me bo pauzë, dalim jasht 15 min.

Kryesuesi - nuk kthehn më.

Alban Berisha - Unë i kërkoj falje sepse nuk e kam personale me askënd por nuk janë gjysma e drejtorave, as Kryetari, as nënkryetari.

Liridon Fandaj - pajtohem me Albanin. Edhe unë kam kërkuar që pika pyetje dhe përgjigje të jetë si pikë e tretë në rend dite por nuk është miratu për arsye që munden me dalë. Por nuk mujn me dal sepse kur po janë pika tjera në diskutim po presin me votu, kështu që herave tjera është mirë të jetë si pikë e tretë në rend dite. Unë kam qenë anëtar i komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Në mbledhjen e këshillave të fshatrave Kryetari ose po i anashkalon ose i mban vetëm kur është vit fushate. Në bazë të udhëzimit janë 6 mbledhje që duhet të mbahen me këshilla të fshatrave dhe kompenzimi i tyre nuk po bëhet në bazë të udhëzimit. Në bazë të udhëzimit thuhet që kryetari i këshillit kompenzohet për 6 takime ekuivalent me komitetet e rregullta që janë KPF dhe Komiteti për Komunitetet. Është një kompenzim që iu ka dhënë atyre në vlerë prej 50€. Realisht është duke u bë një shkelje. Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë: E kam një shqetësim të një fermeri në Dubravë, është një fermë e pulave. Është një rrugë prej 500 m e pa rregulluar që po e dëmton veprimtarinë e tij për bartjen e vezëve. Deri sa ka buxhet me hap rrugë tjera dhe me shtru zhavorr, të kisha lut drejtor që me pas konsideratë dhe me fut këtë rrugë e me rregullu. Pyetja tjetër është për publikimin e dhënjës së serave. Në pjesën e kriterëve nuk përcaktohet cilat janë kriteret për atë që e fiton mbi 1 ari serë por është e përgjithshme. Kjo është dasht me u rregullu, që ata që e fitojnë mbi 1 ari duhet me pas tokë pak më shumë për me marrë atë.

Ardian Kotorri - rruga në Dubravë është më se e nevojshme dhe mundësia e parë që na jepet do të shkojmë dhe besoj shumë shpejt. Sa i përket thirrjes për sera pse 1 ari, unë për dallim prej herave të kaluara, kësaj here e kam bë thirrjen pastaj do të filloj me procedurën e prokurimit për shkak se do ta shoh orientimin e fermerëve se për cilën lloj sere kanë më shumë interes. Thirrja dhe përzgjedhja bëhet për sipërfaqet më të mëdhaja apo për aktivitete të cilat i kanë fermerët dhe për sipërfaqet më të mëdhaja do ti mbështesim. Drejtori tuje jep sqarime.

Liridon Fandaj - kam një pyetje për Drejtorin e Financave dhe Kryetarin. Si ka mundësi që klubi futbollistik „Ballkani“ e ka një kontratë të nënshkruar në 2018-tën dhe është kontratë për 10 vjet. Njëri nen prej kontratës thotë që nëse pagesa nuk kryhet më së largu deri më 5 të muajit të ardhshëm vijues për qeranë që është në vlerë 4050€, atëherë kontrata duhet të shkëputet. Kjo është një shkelje që e ka bë Kryetari dhe nuk e ka shkëput kontratën. Asnjë pagesë nuk e ka bë deri në 2024-tën. Është shumë e rëndë kur një klub tjetër do ti bëj stërvitjet atje, e bën një kërkesë dhe si ti përshtatet këtij ia lejon me bo atë dhe nuk është i përgjegjshëm, edhe ne si kuvend i kem nda 160.000€ subvencion. Në atë stadion ai e ka shkollën e futbollit që inkason mjete prej nxënësve dhe nuk e ka asnjë lehtësim as për veteran, as për invalid të luftës. Kjo është shqetësuese.

Bulëza Kuçi - Kam dy pyetje dhe shpresoj të marrë përgjigje. Parku i qytetit „Shtigjet e ecjes“ e kanë gjendjen shumë për keqardhje. Ka nevojë për rigjenerim të ndriçimit, ka nevojë për pastrim sistematikë, të rregullohen kubëzat, gjithëashtu kam vërejt kohëve të fundit që aty po i prejnë pemët dikush. Rruga e Reqanit është një rrugë e cila i lidh shumë fshatra dhe është e nevojshme të ketë tabela informuese, shenja sinjalizuese, rivendosja e vijave dhe sanimi i disa gropave.

Visar Kuçi - edhe te shtigjet dhe te parku i qytetit gjendja nuk është shumë e mirë. Te shtigjet e ecjes kemi bë disa herë riparime por po ka dëmtime të shtigjeve, karrikave, ndriçimit. Edhe këtë vit kemi nda buxhet dhe do ti renovojmë. Kemi provu në të kaluarën me montu kamera të sigurisë por nuk po lejohet me ligj kurse te parku është duke u investu një pjesë e parkut me sheshin.

Bulëza Kuçi - a ka ndonjë kompani që i pastron shtigjet e ecjes.

Visar Kuçi - me sa e di unë kontratën e ka Eko Regjhioni. Albani tha që nuk po rrin asambleistat dhe drejtorat në asamble. Pikën pyetje dhe përgjigje e kam propozu edhe më herët dhe prap e propozoj që ju ti bëni pyetjet në këtë asamble dhe asamblenë tjetër ne me iu kthy përgjigjen. Unë do të mundohem me qenë çdo herë në asamble edhe pse shumica e drejtorave jemi. Sa i përket sinjalizimit është një kontratë. Unë do

të kujdesem se cilat janë pjesët që duhet të bëhen, kryesisht deri te shkolla „Shkëndija“. Ne çdo herë po mundohemi me mbajtë atë pjesë. Për pjesën e gropave për momentin nuk kemi kontratë të sanimeve por Besoj Drejtoria e shërbimeve publike këtë vit ka me publiku kontratën e re.

Urim Suka - pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Ditë më parë kam pranë një ankesë nga një qytetarë për bllokimin e rrjetit të kanalizimit në rrugën „Xhelal Kuçi“. Sipas qytetarit ky bllokim lidhet me problemet që janë shkaktuar gjatë implementimit të projektit të kolektorit në rrugën Skënderbeu. Unë e kam vizitu këtë vend dhe konstatova që problemi që ai ka është i bazuar. Kërkoj nga drejtoria juaj që të merrni masa për evitimin e dëmit të shkaktuar para se të shkaktohet dëmi shtesë për banorët që e shfrytëzojnë këtë rrejt kanalizimi. E kam dhe një shqetësim ku një qytetar ma ka dërgu një video dhe një foto ku në lokalet përball Rok Hardit në bamesat e mëdhaja një tjegull lart është e dalur nga vendi dhe nëse ajo bjen rreziku mund të jetë me fatalitet. Kisha thënë që në këtë drejtim përmes drejtorisë së Inspeksionit me mujt me i evitu këto që para se me ndodh me i parandalu.

Agim Bylykbashi - nuk kemi kompani të veqantë dhe të vetmit njerëz që duhet ti thërrasim janë zjarrfikësat.

Jehona Rrafshi - në këtë fillim të seancës biseduam për një rast emergjent ku kërkuam ndihmë për një familje por kjo është asambleja jonë dhe vullneti i disa asambleistëve ku kjo pjesë u desht të diskutohet në fund të kësaj seance dhe diskutimi nuk mund të mbahet për shkak të korumit. Kryetar le të mbetet si përgjegjësi që ta caktosh një seancë tjetër dhe si do ti dalim ndihmë kësaj familje.

Selman Kolgeci - kam pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Ju e dini që raporti i HZK-së secilin fillimvit duhet të raportohet për vitin e kaluar. A e ke bërë një raport të tillë dhe kur do ta sjellësh një raport të tillë për me pa ne si po funksionon dhe si po shkon zbatimi i atij plani hapsinor. Drejtor rruga Vraniq-Sopijë e dini që ka shku me zvarritje të shumta por çështja e kapakëve të pusetave nuk janë nivelizu dhe kërkoj intervenim te segmentet të cilat janë asfaltu.

Visar Kuçi - unë si udhëheqës i grupit të monitorimit të HZK-së dhe PZHK-së i kam dërgu gjithë ekipit ku ekipi është prej të gjitha drejtorive. Në drejtorinë time e kam bërë gati por po pres prej drejtorive tjera. Ka me kompletu raportin dhe do ta sjell në asamble.

Qëndrim Elshani - pyetje për Drejtoreshën e Inspeksionit. Ka qarkullu një video në rrjete sociale ku te banesat e portokallta përball Rok Hardit shihem duke punu dy punëtor ku njëri zgjatet me marr diçka dhe tjetri e kap për këmbë. Cilat janë masat që janë marrë nga Drejtoria e Inspeksionit ?

Visar Kuçi - është kontrata nga drejtoria e urbanizmit, ka të bëjë me renovimin e qative të objekteve kolektive. Në mënyrë profesionale është punu aty dhe çka qet video dikush, ne nuk mujna me ndal. Operatori ekonomik edhe në pjesën e përparme dhe pjesën mbrapa objektit e ka vendos skelën dhe e ka renovu kulmin. Unë kam fotografi dhe e kam raportin. Edhe unë e kam pa videon dhe nëse e shikon është shqetësuese por ndoshta e ka edhe rripin e sigurisë.

Qëndrim Elshani - drejtoria e inspeksionit nuk duhet me leju. Është një pengesë në Krushicë të ulët ku e kanë vendos vet banorët. Aty veq se kanë ndodh shumë aksidente dhe kam shqetësim prej banorëve të atij vendbanimi dhe banorëve që kalojnë nëpër atë vendbanim. Pres përgjigje prej Drejtorisë së Inspeksionit. Pyetje për Drejtoreshën e Kulturës. Më keni thënë që keni me sjell një raport por nëse nuk e keni sjell ta kërkoj me shkrim në mënyrë zyrtare.

Lorika Gashi - ta kemi dërgu raportin por ta kemi dërgu sot me vonesë dhe të kërkoj falje.

Kryesuesi - sa i përket çështjes që e ngriti Jehona do të bisedoj me Kryetarin dhe shpresoj me i dal ndihmë asaj familjet por duhet me i ndjek procedurat ligjore.